



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E KULTURËS,
ARSIMIT, RINISË DHE SPORTIT

Nr. 304 Prot
Shkodër, më 09 . 01 .2019

SHOQATA ARTISTIKE “BUNA 2”

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

PËR AKTIVITETIN KULTUROR

“BEST 10 NORTH ”

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi lidhet ndërmjet:

Bashkisë Shkodër, me seli ligjore Rr. “13 Dhjetori”, Shkodër, përfaqësuar nga Znj. Voltana ADEMI në cilësinë e Titullarit të Institucionit,

dhe

Shoqatës Artistike «Buna 2», e regjistruar si person juridik, me nr. Nipti K77314191D dhe e përfaqësuar ligjërisht nga z. Arben Mazi, në cilësinë e presidentit të shoqatës.

BAZA LIGJORE:

Ligji nr 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”

OBJEKTI:

Bashkëpunim me qëllim zhvillimin e aktiviteteve kulturore në kuadër të promovimit dhe zhvillimit të artit, kulturës, turizmit dhe promovimit të territorit.

Duke qenë se:

Bashkia Shkodër ka prioritet mbështetjen dhe zhvillimin e aktiviteteve kulturore, nëpërmjet:

- ✓ Zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë.
- ✓ Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore me interes vendor.
- ✓ Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar lokal si dhe zhvillimin e artit, kulturës, turizmit dhe promovimit të territorit.

Palët bien dakort sa mëposhtë:

QËLLIMI

Shoqata Artistike “Buna 2”, ka si qëllim të sajin gjallërimin e jetës kulturore artistike. Ajo zhvillon veprimtari kulturore, kryesisht në fushën e spektakleve.

Me datën 20 janar 2019, sipas kordinimit me kalendarin e aktiviteteve të Teatrit “Migjeni”, Shoqata Artistike “Buna 2”, do të organizojë spektaklin “Best 10 North”. Qëllimi i këtij projekti konsiston në ndarje çmimesh për personalitete në fusha të ndryshme të jetës social-kulturore në territorin e Bashkisë Shkodër.

Realizimi i këtij spektakli, ka për qëllim nderimin për kontributin në zhvillimin e fushave përkatese të perosnaliteteve të përzgjedhura.

Eksperienca shumë vjeçare e kësaj shoqate, është garanci e padiskutueshme suksesi.

Spektakli “Best 10 North” realizohet në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër dhe Teatrin “Migjeni”.

AFATI I MARRËVESHJES

Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet nga palët me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë, me afat nga momenti i nënshkrimit të saj deri me datë 22.01.2019.



FORMA E BASHKËPUNIMIT

Realizimi nga ana e Shoqatës Artistike “Buna 2”, të spektaklit “Best 10 North” në sallën e Teatrit “Migjeni”. Promovimi i aktivitetit në media dhe në qytet përmes posterave, banerave etj, duke vënë në dukje bashkëpunimin me Bashkinë Shkodër.

Krijimi i kushteve të nevojshme nga ana e administratës së Bashkisë Shkodër dhe e Teatrit «Migjeni» për realizimin me sukses të këtij aktiviteti. Promovimi i aktivitetit në rrjetet online të Bashkisë Shkodër.

KOMUNIKIMI

Çdo komunikim midis palëve do të bëhet me shkrim.

ZGJIDHJA E AKT MARRËVESHJES

Asnjëra nga palët nuk ka të drejtë të zgjidhë aktmarrëveshjen në mënyrë të njëanshme pa shkaqe të arsyeshme dhe para se të kenë njoftuar njëra - tjetrën me shkrim.

Palët bien dakort që çdo mosmarrëveshje apo kontraditë do të përpiqen t'i zgjidhin me mirëkuptim.

Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së aktmarrëveshjes dhe procedurave juridike në fuqi, sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

DISPOZITA TË FUNDIT

Kjo akt marrëveshje do të qohet e vlefshme duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga palët.

Kjo aktmarrëveshje u hartua në tre kopje, nga të cilat njërën e merr shoqata artistike « Buna 2 », ndërsa dy të tjerat i mban Bashkia Shkodër.

**PËR
BASHKINË SHKODËR**

KRYETAR


Voltana Ademi

koncelloj: M. G. ...
Ministër i Kulturës

**PËR
SHOQATËN ARTISTIKE
“BUNA 2”**

PRESIDENT

Arben Mazi

